



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.114

17 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.490, datë 6.7.2011	Për shfuqizimin e vendimeve nr.560 e nr.561, datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa instituteve dhe njërive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” dhe “Për bashkimin e disa instituteve dhe njërive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” 4491
Vendim i KM nr.492, datë 6.7.2011	Për shpërblimin e inspektorit financiar publik 4491
Vendim i KM nr.493, datë 6.7.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” 4492
Vendim i KM nr.496, datë 29.6.2011	Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10 256, datë 25.3.2010 4495
Vendim i KM nr.497, datë 29.6.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrotjtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të Mjedisëve dhe sipërfaqes 2716 m ² , nga trualli funksional i pronës nr.98, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5011” Brar, Tiranë, të

	mjediseve dhe të sipërfaqes 12150 m ² , nga trualli funksional i pronës nr.109, me emërtim “Riparim artilerie” sh.a. Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	4494
Vendim i KM nr.503, datë 13.7.2011	Për miratimin e modelit të uniformave, gradave e shenjave që mbahen në uniformë, si dhe të stemave të strukturave e të flamujve dekorativë, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë	4496
Vendim i KM nr.504, datë 6.7.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 5 bashki dhe 10 komuna	4496
Vendim i KM nr.505, datë 13.7.2011	Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike	4497
Vendim i KM nr.528, datë 20.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.69, datë 2.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014”	4506
Vendim i KM nr.531, datë 20.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar	4510
Vendim i GJL nr.2, datë 21.1.2011	Me objekt: - Anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.58, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKKP Vlorë; të vendimit të AKK Pronave, Tiranë nr.415, datë 22.4.2008. - Anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, të vendimit të AKK Pronave Tiranë nr.414, datë 22.4.2008. - Anulimin e vendimit të KKK Pronave Vlorë, nr.63, datë 19.10.1997. - Anulimin e vendimit nr.38, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë, pika 3. - Anulimin e pikës 1 të vendimit nr.38/1, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë. - Anulimin e vendimit nr.81, datë 14.6.1995. - Anulimin e vendimit nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, si dhe të vendimit nr.18, datë 15.1.2008 të AKK Pronave Tiranë - Detyrimin e të paditurve Fatie Maskaj e Shyqyrete Gega, trashëgimtarëve ligjorë të Ibrahim Aliut (Gega), të njohin paditësit pronarë në lidhje me sipërfaqet e tokës të trajtuar me vendimet nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 14.6.1995 të KKK Pronave Vlorë dhe nr.52, datë	

13.7.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, që janë brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

- Detyrimin e ZRPP Vlorë të fshijë nga regjistrimi në ZRPP Vlorë të pronave të trajtuara nga vendimet e KKK Pronave nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 14.6.1995, nr.63, datë 19.10.1997 e nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë.

- Detyrimin e ZRPP Vlorë të regjistrojë në favor të trashëgimtarëve të Esheref e Mynevere Boçari të pronave objekt i vendimeve nr.58 dhe nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë.

- Të vendoset masë e përkohshme e sigurimit të padisë, duke mos lejuar tjetërsimin e pronave në ZRPP, prona të paluajtshme të trajtuara nga KKK Pronave Vlorë e që janë objekt i anulimit në këtë kërkesëpadi, si dhe depozitimin e kërkesëpadi në ZRPP Vlorë.....

4510

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Ahmetli...

4522

VENDIM
Nr.490, datë 6.7.2011

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE NR.560 E NR.561, DATË 22.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE DHE NJËSIVE KËRKIMORE, ORGANIZIMIN E TYRE NË INSTITUTIN E ENERGJISË, UJIT DHE MJEDISIT, PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT NË PERIUdhËN KALIMTARE” DHE “PËR BASHKIMIN E DISA INSTITUTEVE DHE NJËSIVE KËRKIMORE, ORGANIZIMIN E TYRE NË INSTITUTIN E GJEOSHKENCAVE, PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT NË PERIUdhËN KALIMTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve nr.560 e nr.561, datë 22.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare” dhe “Për bashkimin e disa instituteve dhe njësive kërkimore, organizimin e tyre në Institutin e Gjeoshkencave, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe funksionimin e Institutit në periudhën kalimtare”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.492, datë 6.7.2011

PËR SHPËRBLIMIN E INSPEKTORIT FINANCIAR PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 1 të ligjit nr.10 294, datë 1.7.2010 “Për inspektimin financiar publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektori financiar publik, për periudhën e angazhimit të tij në kryerjen e inspektimit financiar publik, trajtohet financiarisht. Ky trajtim jepet i diferencuar, si më poshtë vijon:

a) Për inspektorin financiar publik, që është nëpunës i administratës publike, trajtimi financiar përfshin, krahas pagës mujore të tij, edhe shpërblimin në masën 3000-5000 lekë në ditë.

Në rastet kur inspektori dërgohet për inspektim jashtë qendrës së tij të punës, ai trajtohet edhe me dietë, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

b) Inspektori financiar publik, kur është ekspert i jashtëm i licencuar i fushës, për kryerjen e detyrës së inspektimit financiar publik shpërblehet në masën 5000-10000 lekë në ditë.

2. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda kufijve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, në përputhje me vështirësinë, volumin apo rëndësinë financiare të inspektimit, të përcaktojë në urdhrin e inspektimit, rast pas rasti, kohëzgjatjen e inspektimit dhe masën fikse të shpërblimit të inspektorit financiar publik.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga kostoja e inspektimit financiar, përfshirë pagesën dhe shpenzimet e udhëtimit, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin vjetor të Ministrisë së Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.493, datë 6.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.929, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 23.4.2011 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 7 dhe 8 të vendimit nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“7. Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet e:

- vdekjes së punonjësit të institucionit. Pagesa i jepet familjes së punonjësit nga titullari i institucionit në masën e një page mujore, por jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

- vdekjes së një anëtari të familjes së punonjësit (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët). Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, për çdo rast;

- sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast;

- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore.

Edhe në rastet kur, sipas ligjeve të veçanta, lindin të drejta specifike të dhënies së ndihmave të menjëhershme, masa e ndihmës së dhënë përballohet nga fondi i veçantë, i përlogaritur sipas pikës 1 të këtij vendimi. Në këto raste specifike, masa e ndihmës jepet pas miratimit nga titullari i institucionit qendror përkatës nëpërmjet një udhëzimi, në të cilin parashikohen rregullat dhe kriteret e përfitimit të këtyre ndihmave.

8. Në veprimtari me karakter social apo kulturor, që përballohen nga fondi i veçantë, përfshihen ato veprimtari të cilat organizohen vetëm për punonjësit e institucionit, sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit dhe të tjera organizime të realizuara nga institucioni. Në çdo rast, masa e shpenzimit, që mbulohet nga fondi i veçantë për këto veprimtari, nuk duhet të kalojë vlerën e 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për punonjës.

Kur veprimtaritë social-kulturore organizohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet e transportit dhe të akomodimit paguhen nga vetë punonjësit.”.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.496, datë 29.6.2011

**PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
GREQISË, PËR KËRKIMIN, ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE VARRIMIN E
USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE
TË VITEVE 1940-1941, DHE PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJES PËR TA, BRENDA
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.10 256,
DATË 25.3.2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10 256, datë 25.3.2010, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes të ndjekë procesin e shpronësimit të trojeve për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, të përcaktuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10 256, datë 25.3.2010, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

2. Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore në bashkinë Këlcyrë, rrethi Përmet, dhe në komunën Dropulli i Sipërm, rrethi Gjirokastrë, të qarkut të Gjirokastrës, të ndjekë zhvillimin e punimeve të këtyre vendprehjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ministria e Mbrojtjes të përballojë shpenzimet për shpronësimet e trojeve për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941.

4. Ministria e Mbrojtjes në bashkërendim me Ministrinë e Brendshme, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për marrjen në administrim të trojeve që do t'i vihen në dispozicion palës greke për ndërtimin e vendprehjeve, sipas ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

5. Me urdhër të Kryeministrit, në zbatim të neneve 2, pika 5, dhe 4, shkronja “a”, të marrëveshjes, do të përcaktohen ekspertët e palës shqiptare në komitetin e përbashkët për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtrave.

6. Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të pikës 8 të nenit 1 të marrëveshjes, të organizojë, në bashkëpunim me palën greke, ceremonitë zyrtare në përkujtim të të rënëve në luftë, çdo vit, në datën 28 tetor.

7. Ministria e Financave të marrë masat e nevojshme për zbatimin e të gjitha procedurave të zhdoganimit dhe të përjashtimit nga detyrimet doganore sipas ligjit nr.10 256, datë 25.3.2010.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.497, datë 29.6.2011

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, TË MJEDISEVE DHE SIPËRFAQES 2716 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.98, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR.5011”, BRAR, TIRANË, TË MJEDISEVE DHE TË SIPËRFAQES 12150 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.109, ME EMËRTIM “RIPARIM ARTILIERIE” SHA, BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të mjediseve dhe sipërfaqes 2716 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.98, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5011” Brar, Tiranë, të mjediseve dhe të sipërfaqes 12150 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.109, me emërtim “Riparim artilerie”, sh.a. Brar, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtimin e rrugës publike “Ura e Brarit-Hyrje tunel Qafë Murrizë”.

2. Mjediset dhe sipërfaqja 2716 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.98, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5011” në Brar, Tiranë, si dhe mjediset dhe sipërfaqja 12 150 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr.109, me emërtim “Riparim artilerie” sh.a. Brar, Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.


4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, para fillimit të punimeve, të ndërtojnë portën hyrëse, kullat dhe murin rrethues në kufijtë e rinj të pronës, të kryejnë spostimin e rrjeteve inxhinierike që preken gjatë punimeve, si dhe të rehabilitojnë infrastrukturën e sipërfaqeve të pronave që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANVENDOSJA E SHA RIPARIM ARTILERIE (BRAR) TIRANË
PRONA 98.109
(PROJEKTI I RRUGËS SË ARBRIT)



VENDIM
Nr.503, datë 13.7.2011

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË UNIFORMAVE, GRADAVE E SHENJAVE QË
MBAHEN NË UNIFORMË, SI DHE TË STEMAVE TË STRUKTURAVE E TË FLAMUJVE
DEKORATIVË, QË MBAJNË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 16 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të uniformave, gradave e shenjave që mbahen në uniformë, si dhe të stemave të strukturave e të flamujve dekorativë, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas albumeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 2. Kalimi në modelin e uniformave, sipas këtij vendimi, të bëhet brenda vitit 2014, ndërsa modelet e stemave të strukturave dhe flamujve dekorativë të aplikohen brenda vitit 2011.
 3. Ministri i Mbrojtjes miraton rregulloren për mënyrën e përdorimit të uniformës nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, si dhe të stemave të strukturave e të flamujve dekorativë.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 5. Vendimi nr.124, datë 4.3.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformave, të gradave dhe shenjave, që mbahen në uniformën ushtarake të Forcave të Armatosura”, shfuqizohet.
 6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.504, datë 6.7.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 5 BASHKI
DHE 10 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht, 5 (pesë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Fondi, në vlerën 100 896 885 (njëqind milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Durrës	60,648,319
2	Bashkia Bulqizë	3,300,000
3	Bashkia Librazhd	2,832,875
4	Bashkia Fier	19,410,500
5	Bashkia Patos	2,178,879
6	Komuna Qukës	564,180
7	Komuna Nikël	602,640
8	Komuna Hajmel	57,410
9	Komuna Kolonjë (Lushnjë)	1,419,642
10	Komuna Hotolisht (Devoll)	820,100
11	Komuna Kolsh (Lezhë)	882,000
12	Komuna Gostimë (Elbasan)	1,973,090
13	Komuna Shënkoll (Lezhë)	1,371,250
14	Komuna Ksamil (Sarandë)	3,802,000
15	Komuna Helmës (Kavajë)	1,034,000
	Shuma	100,896,885

VENDIM

Nr.505, datë 13.7.2011

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzimin për zbatimin e standardeve dhe të procedurave të ofrimit të shërbimeve në përputhje me to.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STANDARDET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, gjatë vlerësimit të mbrojtjes së këtij grupi përfituesish dhe të ekzistencës së qendrave të shërbimeve publike dhe jopublike të OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare, mori nismën për hartimin e një dokumenti, në të cilin do të përfshiheshin standardet e përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje që strehohen në qendrat rezidenciale.

Ky dokument mbështetet në standardet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.6659, datë 17.5.2005. Këto standarde u hartuan në bashkëpunim me një spektër të gjerë organizatash aktive në fushën e shërbimeve sociale dhe dhunës në familje. Hartimi u asistua edhe nga një ekspert, të siguruar përmes UNDP në Shqipëri.

Gjatë hartimit të këtyre standardeve janë marrë në konsideratë të drejtat e sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, CEDAW, Konventa për të drejtat e fëmijëve, ligji nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, ligji nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri, ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar.

Standardet synojnë përmirësimin e jetës së viktimave të dhunës në familje dhe të familjeve të tyre. Ato pasqyrojnë praktikën më të mira në këtë fushë dhe parimet ndërkombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave të personalitetit të individit, të së drejtës për të përfituar dhe për t’u mbrojtur, të mbrojtjes së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit dhe sigurisë, të partneritetit, të integritetit social dhe të pjesëmarrjes në jetën në komunitet.

Ky dokument përbëhet nga shtatë standarde bazë, krahas standardeve, jepen edhe kriteret e vlerësimit, treguesit e matjes së cilësisë së shërbimeve, udhëzues dhe rezultatet e pritura.

Standardet janë hartuar si:

- standarde të shërbimit bazë;

- standarde të detyrueshme për të gjithë personat që ofrojnë shërbime publike dhe jopublike;

Standardet janë një parakusht për ofrimin e shërbimit, procesin e licencimit, kontrollit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale, të cilat ofrohen nga subjekte publike dhe jopublike. Vënia në zbatim e paketës së standardeve të shërbimeve për këtë kategori garanton ofrimin e një shërbimi cilësor për viktimat e dhunës në familje.

Standardi 1

Qëllimi dhe llojet e shërbimeve

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Shërbimet e ofruara nga ofruesi të plotësojnë nevojat individuale të përfituesit si viktimë e dhunës në familje.

Standardi

Ofruesi i shërbimeve ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me ofruesit parësorë dhe alternativë të shërbimeve, për të mundësuar mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

**KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT
PËRKATËS**

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
Ofruesi i shërbimeve të ketë një dokument, ku të shprehet misioni i organizatës, një strukturë të përcaktuar qartë të shërbimeve dhe të ketë treguar kapacitetin për t'i vënë në zbatim shërbimet e deklaruara.	Dokumente në formë shkresore	Këshillohet që në këshillin drejtues të ketë përfitues ose ish-përfitues të shërbimit.
Misioni dhe vizioni të jenë shprehur me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, dhe të jenë afishuar në një vend të dukshëm, si edhe në rregulloret e brendshme.	Dokumentet e afishuara	Dokumenti i misionit duhet të thotë që qendra funksionon mbi bazën e parimeve të sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit të pjesëmarrësit.
Shërbimet minimale të ofruara të jenë: - Strehimi (strehëza); - Veshja; - Ushqimi; - Shërbimet e punës sociale, psikolog; - Referimet; - Liri hyrje ditore.	Kontrata për shërbimet në dosjen e përfituesit	Nevojat/dëshirat e veçanta të përfituesit që nuk nevojiten për arsye mjekësore duhet të përmbushen nga përfituesi.
Shërbime të tjera shtesë që mund të ofrohen, ndër të tjera janë: - Shërbime psikologjike; - Shërbime mjekësore; - Shërbime juridike; - Shërbime dhe formim profesional; - Shërbime financiare; - Asistencë edukative/arsimore.	Kontratë për shërbimet ose aktmirëkuptimi për referimet	Kontratë e nënshkruar, në dosjen e përfituesit ose shënimet e referimit.
Të jenë të ofruara shërbime të specializuara për fëmijët sipas grupmoshave.	Ka person në staf i cili është i specializuar dhe i caktuar për të punuar me fëmijët.	Kontratë e nënshkruar në dosjen nga prindi; plan pune në dosjen e fëmijës.
Përfituesi të ketë nën kontroll sendet vetjake.	Sendet vetjake i ka vetë përfituesi.	
Përfituesi të ketë nën kontroll fëmijët e vet, nëse ka.	Kur përfituesi është nënë me fëmijë, fëmija jeton në të njëjtën dhomë me nënën pasi është bërë një vlerësim mjekësor dhe psiko-social.	
Përfituesi të marrë pjesë në administrimin e programit duke u kujdesur për nevojat e veta, pra duke qenë përgjegjës për hapësirën e vet, fëmijët e vet, gatimin, pastrimin, kujdesin e fëmijës etj., personalisht ose në grup me përfituesit e tjerë. Përfituesit të angazhohen në mirëmbajtjen e mjediseve personale dhe të përbashkëta.	Dokumente ku përcaktohen detyrat e qarta të përdoruesve në lidhje me mirëmbajtjen e mjediseve, plan javor/mujor pune etj.	

Përfituesi të ketë nën kontroll mjetet e veta monetare.		
Përfituesi të jetë i lirë të hyjë dhe të dalë nga qendra, brenda një orari të kufizuar në mënyrë të arsyeshme, por jo jashtë orarit 6:00-22:00, sipas planit të përkujdesit.		

Standardi 2

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesit për përfituesin

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Nevojat e përfituesve të shërbimeve të jenë vlerësuar plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës dhe nevojave të tyre, në funksion të hartimit të planeve individuale të përkujdesit.

Standardi

Ofruesi i shërbimeve të hartojë një plan përkujdesi individual, në bashkëpunim me secilin përfitues të shërbimeve. Në plan të përshkruhen qartë nevojat e vlerësuara të përfituesit dhe veprimet që nevojiten për t'i zgjidhur ose përmbushur këto nevoja.

KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT PËRKATËS

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMI
Menjëherë pas pranimit të klientit, duhet bërë me të orientimi.	Dokumentet e pranimit në dosjen e klientit	Është mirë të mos plotësohen të gjithë formularët gjatë orientimit, duke qenë se klienti mund të mos jetë në gjendje të përqendrohet.
Vlerësimi i nevojave të emergjencës duhet të bëhet brenda 72 orëve duke u pasuar më pas nga vlerësimi i nevojave nga ekipi multidisiplinar në qendër, i cili do të hartojë edhe planin e përkujdesit afatgjatë.	Dokumentet në dosjen e klientit	
Përfituesi të jetë angazhuar aktivisht në planifikimin e rastit (dosjes).	Dokumenti në dosje	Marrëveshja e nënshkruar për të bërë planifikimin të jetë në dosje.

Standardi 3

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesve

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Përfituesit e shërbimeve t'i gëzojnë të gjitha të drejtat sipas legjislacionit në fuqi. Ofruesi i shërbimeve t'i trajtojë ata me respekt dhe dinjitet. Të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit apo diskriminimit.

Standardi

Ofruesit e shërbimeve të nxisin dhe praktikojnë tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa bërë diskriminimin mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzëninë, të qenit prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.

**KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT
PËRKATËS**

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMI
Informimi i përfituesit me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë kohës së qëndrimit në qendër.	Broshurë/fletëpalosje/dokument të afishuar që përfshijnë të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në qendër.	
Duhet të ketë një mekanizëm ankimi për klientët dhe stafin.	Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh qendra.	Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për rrugën që u është dhënë.
Përfituesi të trajtohet si pjesëmarrës në program.	Dokumentet në dosjen e rastit, ku tregohet pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e planit.	Pjesëmarrja e përfituesve është thelbësore për të shkuar drejt vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Standardi 4

Të dhënat personale të përfituesit dhe administrimi i tyre

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Të drejtat dhe interesat më të mira të përfituesve të shërbimeve mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e institucionit për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

Standardi

Ofruesit e shërbimeve të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të vëmendshme. Ofruesi i shërbimeve të krijojë kushtet në mënyrë, që administrimi i të dhënave të bëhet në përputhje me normat ligjore dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

**KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT
PËRKATËS**

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMI
Dosja të jetë konfidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga përfituesi dhe punonjësi social ose administratori i qendrës.	Të dhënat personale mbahen në dosje të mbyllura ose, nëse ruhen në kompjuter, mund të hapen vetëm me fjalëkalim nga personi përgjegjës.	
Për identifikimin e përfituesit në dosje të përdoren vetëm numra të zgjedhur në mënyrë të rastësishme.	Respektim i dosjeve	
Për fëmijët, të mos përdoren inicialet, por fëmija 1,2 etj., i prindit.	Respektim i dosjeve	
Dosja të përmbajë raportin e policisë për evidentimin dhe trajtimin e rastit; urdhrin e lëshuar nga gjykata për vendosjen e përfituesit në institucion, si edhe dokumente të tjera që do të gjykohen të	Dosja e përfituesit	Shpesh, një përfitues nuk vendos t'i drejtohet menjëherë sistemit të drejtësisë penale, por më vonë mund të ndërrojë mendje. Pra, është mirë të ruhen prova për t'ia rritur mundësitë përfituesit.

<p>përshtatshme për të identifikuar përfituesin si viktimë të dhunës në familje.</p> <p>Nëse përfituesi nuk është vizituar nga një mjek, dokumentet e pranimit të përfshijnë një hartë trupore dhe, nëse është nevoja, fotografi të lëndimeve, të cilat mund të përdoren më vonë.</p>		
<p>Qendra të ketë rregulla të përcaktuara në lidhje me reagimin ndaj ftesës për të dëshmuar dhe urdhrave gjyqësore.</p>	<p>Rregullorja e institucionit</p>	<p>Qendrat duhet të diskutojnë dhe të vendosin paraprakisht se deri ku duhet të shkojnë për të mbrojtur fshehtësinë e të dhënave dhe për të mos i dorëzuar dosjet edhe kur këtë ua kërkojnë organet zyrtare. Organet e forcave të ligjit nuk kanë liri shikimi të informacionit pa urdhër të gjykatës, për të cilin qendrës i jepet kohë e mjaftueshme për t'u përgjigjur.</p>
<p>Përfituesit t'i jepet mundësia ta shohë dosjen, nëse stafi nuk vendos dhe nuk konfirmohet nga administratori që do të ishte e dëmshme një gjë të tillë.</p>	<p>Mbahet një bazë të dhënash për të gjitha kërkesat për të shikuar dosjen.</p>	<p>Nëse hidhet poshtë kërkesa, është mirë të shprehet qartë arsyeja dhe të përfshihet në dosje.</p>
<p>Nëse ka informacion që mund të vendosë në rrezik përfituesin ose një person tjetër, në përputhje me kodin etik të profesionistëve të shërbimeve sociale, ofruesi i shërbimeve është i detyruar të informojë drejtorin e ofruesit të shërbimeve. Ky i fundit duhet të informojë autoritetet e forcave të ligjit.</p>	<p>Në dosje duhet të ketë një formular, ku të jepet arsyeja e njoftimit dhe logjika mbështetëse e saj.</p>	
<p>Edhe në ato raste kur përfituesi ka dhënë pëlqimin me shkrim për dhënien e informacionit personal dhe/ose të informacionit të fshehtë të të tretëve, ofruesi i shërbimeve është i detyruar të vlerësojë përmbajtjen e këtyre të dhënave për të garantuar që dhënia e informacionit nuk përbën rrezik për përfituesin, anëtarët e familjes apo stafin. Nëse është i pranishëm një rrezik i tillë,</p>	<p>Të gjitha këto refuzime duhet të dokumentohen në dosje, së bashku me shpjegimin.</p>	

ofruesi i shërbimit ka të drejtë të mos e japë informacionin.		
Të dhënat e përfituesve të ruhen dhe të mbahen për aq kohë sa parashikon legjislacioni në fuqi.		

Standardi 5

Administrimi i brendshëm i qendrës së shërbimit

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Përmes administrimit të brendshëm, ofruesit e shërbimeve të sigurojnë shërbimin dhe funksionimin eficient për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mira në terren.

Standardi

Secili ofrues i shërbimeve të ketë mekanizmat e duhura formale të administrimit të brendshëm për funksionimin e qendrës dhe ekzekutimin e shërbimeve që ofron.

KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT PËRKATËS

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMI
Ofruesi i shërbimeve të ketë strukturën e nevojshme dhe stafin e kualifikuar/me përvojë për të realizuar shërbimet. Stafit duhet të përfshijë një drejtor dhe një staf të aftë teknik, për të siguruar shërbime me cilësi të lartë dhe staf administrativ dhe mbështetës për të siguruar realizimin e shërbimeve me cilësi të lartë.	Organigrama e ofruesit të shërbimeve, ku përcaktohen qartë postet dhe hierarkia. Dosjet individuale të stafit, ku përfshihen CV, diploma, vërtetimi se nuk ka pasur ndjekje penale, kopje të diplomave, rekomandime, trajnime, përshkrimet e punës dhe kontratat e punës, vlerësimet e punës, vërtetime mjekësore, për secilin punonjës. Përshkrimi dhe kontratat e punës janë nënshkruar nga drejtori i ofruesit të shërbimeve dhe secili punonjës. Apel i përditshëm i qendrës dhe dosjet e punonjësve.	Është mirë që i gjithë stafi të rekrutohet me konkurrim të hapur dhe të punësohet në bazë të aftësive dhe përvojës, sipas legjislacionit në fuqi.
Stafi i punësuar të jetë i përshtatshëm për nevojat e përfituesve.		Ofruesi i shërbimeve mund të vendosë të punësojë vetëm punonjëse femra për shkak të natyrës së shërbimeve dhe dinamikës së dhunës në familje. Ish-pjesëmarrëset e programit të cilat kanë më shumë se 6 muaj që janë larguar nga programi, ish-viktima të dhunës në familje që kanë të paktën 6 muaj që nuk dhunohen, kanë përparësi dhe mund t'i zëvendësojnë kërkesat për diplomë me vitet e

		përvojës. Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
Stafi të rekrutohet sipas një procedure të përcaktuar. Gjendja shoqërore, juridike dhe mjekësore e punonjësve të mos përbëjë asnjë kërcënim ndaj funksionimit të ofruesit të shërbimeve apo ndaj mirëqenies së përfituesve.	Kjo të jetë e vërtetuar me dokumentacionin përkatës.	
Secili punonjës i ri të trajnohet nga ofruesi i shërbimeve ose nga ndonjë person tjetër dhe/ose në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ofruesi i shërbimeve të sigurojë trajnim të vazhdueshëm profesional dhe teknik të stafit, në përputhje me nevojat.	Të ofrohet certifikatë për çdo trajnim dhe një kopje të vendoset në dosjen e punonjësit.	Është shumë e rëndësishme përzgjedhja e kujdesshme e trajnimit, për të ruajtur filozofinë e qendrës, që është siguria, vetëmjaftueshmëria dhe fuqizimi i përfituesve.
Stafi minimal të përbëhet nga: administratori ose ekipi administrativ, llogaritari, sektori social.	Dosjet e punonjësve me vërtetime të kualifikimeve përkatëse.	Stafi ndryshon sipas nevojës dhe mundësive.
Vlerësimet e stafit të bëhet të paktën çdo vit dhe të konsistojnë në vlerësime 360 gradë, domethënë kërkesa për marrjen e mendimeve nga të gjithë kolegët në ofruesit e shërbimeve.	Procedura dhe kriteret e vlerësimit në manual dhe vlerësimet në dosjet e stafit.	Është e rëndësishme të parandalohet qarkullimi i stafit dhe të mbahet stafi nëse ka një shkallë karriere për punonjësit. Pra është e rëndësishme për vlerësimin që punonjësit të mund të ngrihen në përgjegjësi brenda së njëjtës organizatë ose nga njëra organizatë në tjetrën.

Standardi 6

Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Stafi dhe përfituesit e shërbimeve të ndjehen të sigurt dhe jo të kërcënuar për jetën e tyre dhe të personave të tjerë në mjediset e ofruesit të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve i administron në kohë situatat emergjente në mjediset e tyre.

Standardi

Ofruesi i shërbimeve të marrë masat për sigurinë e stafit të duhur dhe të përfituesve. Institucioni i ofruesit të shërbimeve të mbahet i paprekur dhe të ruhet fshehtësia e vendndodhjes së tij në çdo kohë. Çdo ofrues shërbimi të përcaktojë qartë mënyrat e trajtimit të situatave emergjente dhe të rreziqeve.

KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT PËRKATËS

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
Ofruesi i shërbimeve të bëjë një vlerësim të plotë dhe profesional të sigurisë së mjediseve të brendshme dhe të mjedisit të jashtëm ku do të strehohen përfituesit, përpara se të vendosë për ta hapur qendrën.	Dokument në dosje, nga personeli i vlerësimit të sigurisë	Është mirë që ky vlerësim të bëhet çdo vit.
Ofruesi i shërbimeve të ketë një marrëdhënie të vazhdueshme me postën më të afërt të policisë për të siguruar mbrojtje në situata emergjente.	Dokument në dosje, nga posta më e afërt e policisë	Sidomos nëse qendra vendos të ketë adresë publike, është jetike të ketë marrëdhënie me forcat e ligjit për të siguruar një reagim të shpejtë. Ofruesi i shërbimeve garanton ruajtjen e objektit me shërbime të specializuara.
Ofruesi i shërbimeve të trajnojë punonjësit për çështjet e sigurisë dhe masat përkatëse për të siguruar sigurinë në rastet që paraqesin rrezik ndaj përfituesve dhe vetë stafit.	Modul trajnimi, listat e pjesëmarrësve	Moduli i trajnimit mund të përfshijë: -Teknikat bazë të vetëmbrojtjes për stafin dhe, mbase edhe për përfituesit; - Ndërgjegjësim për ndihmën e shpejtë për administratorët e qendrave dhe për stafin jomjekësor; - Ndërgjegjësim për vlerësimin e sigurisë dhe rreziqeve; - Diskutime të rregullta me stafin për incidentet kur stafi ose përfituesit janë ndjerë të frikësuar dhe se si mund të parandalohen situata të tilla në të ardhmen.
Ofruesi i shërbimeve të dërgojë pranë Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) adresën për vendndodhjen e qendrës dhe listën e përfituesve që do të kenë nevojë për shërbim shëndetësor.	Kontrata e lidhur mes Qendrës dhe ISKSH-së	Kontrata do të lidhet për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sipas paketës bazë në kujdesin shëndetësor parësor dhe nëpërmjet sistemit të referimit, shërbim të specializuar dytësor dhe terciar. Lista e përfituesve që do të kenë nevojë për shërbim shëndetësor të ketë të

		identifikuar përfituesit sipas moshës dhe gjinisë, gjithashtu të jetë përcaktuar edhe nëse këta përfitues janë të siguruar në skemën e sigurimeve shëndetësore.
--	--	---

Standardi 7

Monitorimi dhe vlerësimi

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.

Standardi

Ofruesi i shërbimeve të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara, për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.

KRITERET E PËRMBUSHJES SË STANDARDIT, TREGUESIT DHE UDHËZUESIT PËRKATËS

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
Secili ofrues i shërbimeve të ketë strukturën e vet, së cilës t'i jetë ngarkuar detyra e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përmbushur.	Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramë dhe përshkrimet e punës. Vlerësimi në dosje.	Është mirë të tregohet gjithmonë kujdes për zhvillimet në fushën e udhëzimeve për praktikën më të mira dhe synimet e sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

VENDIM

Nr.528, datë 20.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.69, DATË 2.2.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR PERIUdhËN 2012-2014"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr.1, nr.2 dhe nr.2/1, bashkëlidhur vendimit nr.69, datë 2.2.2011, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me lidhjet nr.1, nr.2 dhe nr.2/1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
						Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	3.16	3.17	3.18	3.19	3.21	3.22	3.23	3.23
Norma e inflacionit (mesatar)	%	2.9	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	3.6	4.7	2.3	2.5	2.7	1.6	1.5	1.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	90.4	83.9	95.0	103.9	100.5	102.0	102.5	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.9	122.8	131.6	137.8	139.1	139.0	139.2	139.2
Rritja reale e PBB	%	5.9	7.5	3.3	3.8	5.0	5.1	5.0	5.2
PBB	Lek miliardë	967.7	1,089.3	1,151.0	1,224.9	1,319.8	1,408.9	1,501.7	1,602.0
PBB	USD miliardë	10.7	13.0	12.1	11.8	13.1	13.8	14.7	15.4
PBB	Euro miliardë	7.8	8.9	8.7	8.9	9.5	10.1	10.8	11.5
PBB për banor	Lek mijë	306.0	343.8	361.4	383.4	411.7	437.9	465.1	495.6
PBB për banor	USD	3,384.3	4,098.6	3,804.9	3,689.3	4,096.4	4,293.4	4,537.5	4,765.4
PBB për banor	Euro	2,470.5	2,800.8	2,746.5	2,782.8	2,959.7	3,150.6	3,341.2	3,561.6
PBB për banor	USD-PPP	7,116.9	7,996.3	8,405.2	8,917.0	9,574.2	10,184.4	10,816.2	11,525.6
Norma e papunësisë	%	13.2	12.7	13.8	13.3	12.7	11.6	10.4	9.3
Llogarëna korente	% të PBB	-10.6	-15.5	-15.5	-11.9	-11.5	-10.2	-9.1	-7.9
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.9	-27.4	-26.5	-23.5	-21.5	-19.1	-17.7	-16.3
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.2	0.8	1.4	2.2	3.0	3.0	3.6	3.8
Bilanci i Pagesave	% të PBB	1.9	2.2	-0.4	0.7	1.2	2.4	3.4	3.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Lidhja Nr. 2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR ne milion Leke

Nr.	E M E R T I M I	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
						Buxheti Rialikuar	PBA	PBA	PBA
TOTALI TE ARDHURAVE		251,555	291,238	298,981	324,721	344,047	367,212	391,749	417,851
I.	Ndihmat	1,280	4,228	4,430	4,605	8,422	11,480	14,112	14,887
II.	Te ardhura tatimore	228,164	264,421	270,830	288,564	315,397	340,603	367,700	397,713
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	176,808	205,292	208,870	223,019	242,077	260,658	281,612	304,816
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	87,771	107,094	110,062	113,998	120,056	129,245	139,406	151,154
2	Tatimi mbi Fitimin	21,077	18,108	17,149	17,606	21,127	22,794	24,772	26,843
3	Akizat	28,731	32,510	33,504	38,788	41,270	44,606	48,212	52,211
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	14,850	24,498	26,820	27,058	29,493	31,879	34,645	37,473
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	14,531	14,423	13,405	18,295	22,320	25,106	27,142	29,264
6	Taksa Doganore	9,848	8,660	7,929	7,274	7,812	7,028	7,434	7,872
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	9,366	11,307	12,149	11,898	15,300	18,863	22,348	26,356
1	Taksa lokale	7,134	7,137	8,154	7,684	10,930	13,108	15,861	19,033
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0	1,586	1,509	1,896	1,850	2,815	3,293	3,853
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2,232	2,584	2,486	2,318	2,520	2,940	3,192	3,469
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	41,989	47,822	49,812	53,647	58,020	61,082	63,742	66,541
1	Sigurimi Shoqeror	37,562	42,547	44,344	45,041	50,010	52,486	54,943	57,405
2	Sigurimi Shendetesor	4,427	5,275	5,467	6,432	6,610	7,096	7,598	8,136
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve					1,400	1,500	1,200	1,000
III.	Te ardhura jotatimore	22,112	22,588	23,720	31,552	20,228	15,129	9,937	5,251
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	5,010	5,700	6,241	4,936	5,200	4,000	3,500	3,100
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	9,458	8,919	9,338	13,994	10,323	8,929	5,137	1,551
3	Dividenti	0	6,402	374	735	500	700	500	300
4	Tarifat sherbimeve	0	0	4,183	2,977	3,000	1,000	600	200
5	Te tjera	7,644	1,567	3,584	8,910	1,205	500	200	100
TOTALI I SHPENZIMEVE		285,874	351,492	379,863	362,752	390,859	408,776	436,048	464,910
I.	Shpenzime Korrente	224,976	250,298	283,898	300,878	311,538	331,034	354,260	378,133
I.1	Personeli	59,087	66,621	62,359	65,762	68,747	71,701	74,304	77,057
1	Paga	49,663	55,983	53,272	58,951	58,734	60,954	63,222	65,433
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	9,425	10,637	9,087	8,811	9,013	9,447	9,782	10,124
3	Politikat e reja pagash	0	0	0	0	1,000	1,300	1,300	1,500
I.2	Interesat	25,594	31,307	36,301	41,604	46,838	51,300	56,918	59,812
1	Te brendshme	23,499	28,386	31,408	35,583	38,700	41,700	46,600	49,700
2	Te Huaja	2,096	2,921	4,893	6,021	8,138	9,600	10,318	10,112
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	25,259	28,788	32,058	34,318	28,971	29,917	31,255	33,130
I.4	Subvencionat	3,536	2,555	2,004	3,535	1,759	1,600	1,500	1,400
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	69,892	76,199	96,725	106,207	116,201	122,724	130,757	138,848
1	Sigurime Shoqerore	60,824	65,823	73,744	79,316	85,100	90,140	96,414	102,698
2	Politika te reja pensionesh	0	0	0	0	1,634	1,650	1,700	1,800
3	Sigurime Shendetore	9,068	10,376	22,980	25,141	27,767	28,934	30,443	31,850
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0	0	0	1,750	2,000	2,000	2,200	2,500
I.6	Buxheti lokal	21,340	27,079	33,583	30,764	29,314	33,493	37,828	42,888
1	Buxheti lokal (Granti)	11,973	15,772	21,434	18,866	14,014	14,630	15,480	16,530
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e vota)	9,366	11,307	12,149	11,898	15,300	18,863	22,348	26,356
I.7	Shpenzime te tjera	15,268	17,750	20,867	18,688	19,708	20,300	21,700	23,000
1	Pagesa e papunesise	869	825	868	982	1,050	1,000	1,100	1,100
2	Ndihma Ekonomike	13,491	15,925	16,060	16,706	16,858	17,300	18,300	19,400
3	Kompensim per te perndjekurit politike	0	1,000	2,200	1,000	1,800	2,000	2,300	2,500
4	Kompensim per energjin elektrike	408	0	0	0	0	0	0	0
II.	Fondi Rezerve	0	0	0	0	5,575	5,500	7,500	11,500
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0	0	0	0	1,928	1,500	1,500	1,500
2	Fondi Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0	0	0	0	3,647	4,000	6,000	10,000
III.	Shpenzime Kapitale	57,040	93,783	95,881	67,492	73,746	72,242	74,288	77,277
1	Financimi Brendshem	48,220	50,046	75,600	46,642	41,023	31,000	21,962	23,619
2	Financimi Huaj	8,819	43,587	20,281	20,850	32,523	41,242	52,326	53,658
IV	Transferu te ndryshme	3,658	7,411	85	-5,618	0	0	0	0
DEFICITI		-34,119	-60,254	-80,883	-38,031	-46,812	-41,564	-44,299	-47,259
FINANCIMI DEFICITIT		34,119	60,254	80,883	38,031	46,812	41,564	44,299	47,259
Brendshem		28,829	24,417	70,701	27,819	30,062	21,982	18,154	25,345
Te ardhura nga Privatizimi		13,246	5,538	25,138	411	300	300	300	300
Hua-marje e brendeshme		17,039	18,012	43,339	25,948	29,463	21,682	17,854	25,045
Te tjera		-1,456	866	2,224	1,460	300	0	0	0
I Huaj		5,289	35,837	10,182	10,212	16,750	19,582	26,144	21,914
Hua afatgjate(e marre)		9,109	39,974	15,375	18,429	26,601	29,762	38,214	38,971
Ndryshimi i gjendjes se arkës Ripagesat		279	292	567	-1,705	0	0	0	0
Ripagesat		-4,098	-4,248	-5,760	-6,512	-9,851	-10,180	-12,070	-17,057
MEMO:									
Borxhi Publik Total (Stok)		516,923	595,786	682,403	715,475	784,186	834,219	880,592	929,386
Borxhi publik nga buxheti (stock)		489,521	559,238	636,629	670,049	716,262	757,526	801,525	848,483
I Brendshem (stock)		369,536	395,504	409,501	401,821	431,284	452,966	470,820	495,865
I Huaj (stock), nga i cili:		119,985	163,734	227,128	268,228	284,978	304,560	330,704	352,618
Pushteti Vendor (stock)		0	0	0	147	219	500	1,500	1,500
Borxhi publik jashte buxhetit (stock)		27,402	36,548	45,774	45,425	67,924	76,693	79,067	80,902
Borxhi publik i garantuar (stock)		27,402	36,548	45,774	45,425	47,184	52,933	50,095	46,528
Borxh nga disbursimet jashte buxhetit (stock)						10,800	8,800	8,800	8,800
Provigion per riskun nga kursi i kombimit (flow)						9,940	5,020	5,212	5,403
PBB nominal		987,870	1,089,293	1,151,020	1,224,881	1,319,838	1,408,939	1,501,670	1,601,982

Burimi: Ministria e Financave

Lidhja Nr. 2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne % te Produktit te Brendshem Bruto

Nr.	E M E R T I M I	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
						Buxheti Rishikuar	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26.0	26.7	26.0	26.5	26.1	26.1	26.1	26.1
I.	Ndihmat	0.1	0.4	0.4	0.4	0.6	0.8	0.9	0.9
II.	Te ardhura tatimore	23.6	24.3	23.5	23.6	23.9	24.2	24.5	24.8
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	18.3	18.8	18.1	18.2	18.3	18.5	18.8	19.0
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	9.1	9.8	9.6	9.3	9.1	9.2	9.3	9.4
2	Tatimi mbi Fitimin	2.2	1.7	1.5	1.4	1.6	1.6	1.6	1.7
3	Akcizat	3.0	3.0	2.9	3.2	3.1	3.2	3.2	3.3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	1.5	2.2	2.3	2.2	2.2	2.3	2.3	2.3
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.5	1.3	1.2	1.5	1.7	1.8	1.8	1.8
6	Taksa Doganore	1.0	0.8	0.7	0.6	0.6	0.5	0.5	0.5
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1.0	1.0	1.1	1.0	1.2	1.3	1.5	1.6
1	Taksa lokale	0.7	0.7	0.7	0.6	0.8	0.9	1.1	1.2
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0.0	0.1	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	4.3	4.4	4.3	4.4	4.4	4.3	4.2	4.2
1	Sigurimi Shoqeror	3.9	3.9	3.9	3.7	3.8	3.7	3.7	3.6
2	Sigurimi Shendetsor	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Te ardhura jotatimore	2.3	2.1	2.1	2.6	1.5	1.1	0.7	0.3
1	Tran.Fitimi nga Banke e Shqiperise	0.5	0.5	0.5	0.4	0.4	0.3	0.2	0.2
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	1.0	0.8	0.8	1.1	0.8	0.6	0.3	0.1
3	Dividenti	0.0	0.6	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Tanfat sherbimeve	0.0	0.0	0.4	0.2	0.2	0.1	0.0	0.0
5	Te tjera	0.8	0.1	0.3	0.7	0.1	0.0	0.0	0.0
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.5	32.3	33.0	29.6	29.6	29.0	29.0	29.0
I.	Shpenzime Korrente	23.2	23.0	24.7	24.6	23.6	23.5	23.6	23.5
I.1	Personeli	6.1	6.1	5.4	5.4	5.2	5.1	4.9	4.8
1	Paga	5.1	5.1	4.6	4.6	4.5	4.3	4.2	4.1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	1.0	1.0	0.8	0.7	0.7	0.7	0.7	0.6
3	Politikat e reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
I.2	Interesat	2.6	2.9	3.2	3.4	3.5	3.6	3.8	3.7
1	Te brendshme	2.4	2.6	2.7	2.9	2.9	3.0	3.1	3.1
2	Te Huaja	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.7	0.6
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2.6	2.6	2.8	2.8	2.2	2.1	2.1	2.1
I.4	Subvencionet	0.4	0.2	0.2	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	7.2	7.0	8.4	8.7	8.8	8.7	8.7	8.7
1	Sigurime Shoqerore	6.3	6.0	6.4	6.5	6.4	6.4	6.4	6.4
2	Politika te reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
3	Sigurime Shendetsore	0.9	1.0	2.0	2.1	2.1	2.1	2.0	2.0
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2
I.6	Buxheti lokal	2.2	2.5	2.9	2.5	2.2	2.4	2.5	2.7
1	Buxheti lokal (Granti)	1.2	1.4	1.9	1.5	1.1	1.0	1.0	1.0
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	1.0	1.0	1.1	1.0	1.2	1.3	1.5	1.6
I.7	Shpenzime te tjera	1.6	1.6	1.8	1.5	1.5	1.4	1.4	1.4
1	Pagesa e papunesise	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma Ekonomike	1.4	1.5	1.4	1.4	1.3	1.2	1.2	1.2
3	Kompensim per te pmdjekurit politike	0.0	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
4	Kompensim per energjin elektrike	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	Fondi Rezerve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.4	0.5	0.7
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Fond Kontingjence per ruajtjen e deficitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.4	0.6
III.	Shpenzime Kapitale	5.9	8.6	8.3	5.5	5.6	5.1	4.9	4.8
1	Financimi Brendshem	5.0	4.6	6.6	3.8	3.1	2.2	1.5	1.5
2	Financimi Huaj	0.9	4.0	1.8	1.7	2.5	2.9	3.5	3.3
IV.	Transferta te ndryshme	0.4	0.7	0.0	-0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFICITI	-3.5	-5.5	-7.0	-3.1	-3.5	-3.0	-3.0	-3.0
	FINANCIMI DEFICITIT	3.5	5.5	7.0	3.1	3.5	3.0	2.9	3.0
	Brendshem	3.0	2.2	6.1	2.3	2.3	1.6	1.2	1.6
	Te ardhura nga Privatizimi	1.4	0.5	2.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Hua-marre e brendeshme	1.8	1.7	3.8	2.1	2.2	1.5	1.2	1.6
	Te tjera	-0.2	0.1	0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	I Huaj	0.5	3.3	0.9	0.8	1.3	1.4	1.7	1.4
	Hua afatgjate(e marre)	0.9	3.7	1.3	1.5	2.0	2.1	2.5	2.4
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripagesat	-0.4	-0.4	-0.5	-0.5	-0.7	-0.7	-0.8	-1.1
	MEMO:								
	Borxhi Publik Total (Stok)	53.4	54.7	59.3	58.4	59.4	59.2	58.6	58.0
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	50.6	51.3	55.3	54.7	54.3	53.8	53.4	53.0
	I Brendshem (stok)	38.2	36.3	35.6	32.8	32.7	32.1	31.4	31.0
	I Huaj (stok), nga i cili:	12.4	15.0	19.7	21.9	21.6	21.6	22.0	22.0
	Pushteti Vendor (stok)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1
	Borxhi publik jashte buxhetit (stok)	2.8	3.4	4.0	3.7	5.1	5.4	5.3	5.1
	Borxhi publik i garantuar (stok)	2.8	3.4	4.0	3.7	3.6	3.8	3.3	2.9
	Borxh nga disbursemet jashte buxhetit (stok)					0.8	0.6	0.6	0.5
	Provizion per riskun nga kursi i kembimit (flow)					0.8	0.4	0.3	0.3
	PBB nominal	967,670	1,089,293	1,151,020	1,224,881	1,319,836	1,408,938	1,501,670	1,601,982

Burimi: Ministria e Financave

VENDIM
Nr.531, datë 20.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” e 26 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 20 të vendimit nr.140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1. Numri i punonjësve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.2, datë 21.1.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara së Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	kryesuese
Ardian Dvorani	anëtar
Gani Dizdari	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar,

në seancën gjyqësore të datës 21.1.2011, mori në shqyrtim çështjen civile që u përket palëve:

PADITËS: Agron Boçari, i biri i Esherefit, lindur në Vlorë, datëlindja 1939, banues në Tiranë, përfaqësuar nga Avokati Ervin Pupa.

TË PADITUR: - Zyra rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Kadri Skera.

- Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, përfaqësuar nga z.Andi Çuadari.
- Fatie Maskaj, e bija e Ibrahimit, vitlindja 1929, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, prezent pa avokat.

- Shyqyrete Gega, e bija e Ibrahimit dhe e Pashkos, datëlindja 16.2.1928, lindur në Tërbaç, Vlorë dhe banuese në Vlorë (në mungesë).

- Kimete Bedini, e bija e Enverit, vitlindja 1939, lindur dhe banuese në Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga av.Gëzim Liçaj.

- Artan Liçaj, i biri i Liços, vitlindja 1962, lindur dhe banues në Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga av.Gëzim Liçaj.

PERSON I TRETË: Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Kadri Skera.

OBJEKTI PADISË: Anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.58, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKKP Vlorë; të vendimit të AKK Pronave, Tiranë nr.415, datë 22.4.2008 që ka lënë në fuqi vendimin nr.58, datë 31.8.2007, si dhe detyrimin për njohjen dhe kthimin e pronës trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit Esheref Dano, të trajtuar me vendimin e sipërcituar, pronë me sipërfaqe 950 vreten ose 118.75 ha, e ndodhur në vendin Shkallë, me kufij: L-Kullota e Memisha Beqiri dhe Hajredin Muharremi, V-Kullota e Shën Seit Kaninës, L-Esheref Dano, P-Deti, J-Përroi që ndan kufirin e Radhimës.

Anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, të vendimit të AKK Pronave Tiranë nr.414, datë 22.4.2008, që ka lënë në fuqi vendimin nr.59, datë 31.8.2007, si dhe detyrimin për njohjen dhe kthimin e pronës trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronares Mynever Boçari, të trajtuar me vendimin e sipërcituar, pronë me sipërfaqe 150 vreten ose 18.75 ha, ndodhur në vendin “Shkallë”, Jonufër, me kufizimet: L-Esheref Dano, P-Deti, J-Përrua dhe vendi “Porta”, V-Vendi “Shkallë”.

Anulimin e vendimit të KKK Pronave Vlorë, nr.63, datë 19.10.1997 në favor të Kimete Bedinit për kompensimin fizik të tokës së saj bujqësore në fshatin Armen, me 4131.8 m² në parcelën nr.31 Jonufër-Vlorë, si dhe pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit me nr.676 Rep. e 456 Kol., datë 10.9.1999 me anë të së cilës Kimete Bedini i ka dhuruar djalit të saj, Artan Liçaj, 4231.8 m² me vendndodhje në parcelën nr.31 Jonufër-Vlorë.

Anulimin e vendimit nr.38, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë, pikën 3 të tij, dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Anulimin e pikës 1 të vendimit nr.38/1, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliu, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Anulimin e vendimit nr.81, datë 14.6.1995 dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliu, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Anulimin e vendimit nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, si dhe të vendimit nr.18, datë 15.1.2008 të AKK Pronave Tiranë, me të cilin është ndryshuar pika 2/a e vendimit nr.52, vendim me anë të të cilit janë njohur pronarë dhe u është kthyer prona trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut, pronë (për pjesën) e cila ka mbivendosje dhe është brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Detyrimin e të paditurve Fatie Maskaj e Shyqyrete Gega, trashëgimtarëve ligjorë të Ibrahim Aliu (Gega), të njohin paditësit pronarë në lidhje me sipërfaqet e tokës të trajtuar me vendimet nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994 nr.81, datë 14.6.1995 të KKK Pronave Vlorë dhe nr.52, datë 13.7.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë, që janë brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Detyrimin e ZRPP Vlorë të fshijë nga regjistrimi në ZRPP Vlorë të pronave të trajtuara nga vendimet e KKK Pronave nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 14.6.1995, nr.63, datë 19.10.1997 e nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë.

Detyrimin e ZRPP Vlorë të regjistrojë në favor të trashëgimtarëve të Esheref e Mynevere Boçari të pronave objekt i vendimeve nr.58 dhe nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të AKK Pronave Vlorë.

Të vendoset masë e përkohshme e sigurimit të padisë, duke mos lejuar tjetërsimin e pronave në ZRPP, prona të paluajtshme të trajtuara nga KKK Pronave Vlorë e që janë objekt i anulimit në këtë kërkesëpadi, si dhe depozitimin e kërkesëpadi në ZRPP Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 1 i Protokollit të Konventës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 41, 42, 122/2); ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për KKK Pronave” i ndryshuar me nenin 18 të ligjit nr.9283, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004”, ligji nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, Kodi i Procedurës Civile, nenet 31, 31/a, 153, 202/a, 206, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.747, datë 9.11.2006, nr.566, datë 23.8.2006, Kodi Civil, neni 92/a.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.1814, datë 6.7.2009, ka vendosur:

Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor, çështjen civile nr.regj.them.2114, datë 30.5.2008, me palë ndërgjyqëse paditës Agron Boçari, palë të paditura Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Fatie Maskaj, Shyqyrete Gega, Kimete Bedini, Artan Liçaj, person i tretë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me objekt anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.58, datë 31.8.2007, të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Vlorë, të vendimit nr.415, datë 22.4.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë dhe që ka lënë në fuqi vendimin nr.58, datë 31.8.2007, si dhe detyrimin për njohjen dhe kthimin e pronës trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit Esheref Dano, të trajtuar me vendimin e sipërcituar, pronë me sipërfaqe 950 vreten ose 118.75 ha e ndodhur në vendin Shkallë, me kufij: L-Kullota e Memisha Beqiri dhe Hajredin Muharremi, V-Kullota e Shën Seit Kaninës, L-Esheref Dano, P-Deti, J-Përroi që ndan kufirin e Radhimës. Anulimin si të pabazuar në ligj dhe në prova të vendimit nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, të vendimit nr.414, datë 22.4.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë që ka lënë në fuqi vendimin nr.59, datë 31.8.2007, si dhe detyrimin për njohjen dhe kthimin e pronës trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronares Mynevere Boçari, të trajtuar me vendimin e sipërcituar, pronë me sipërfaqe 150 vreten ose 18.75 ha, ndodhur në vendin “Shkallë”, Jonufër me kufizimet L-Esheref Dano, P-Deti, J-Përrua dhe vendi “Porta”, V-Vendi “Shkallë”. Anulimin e vendimit të KKK Pronave Vlorë nr.63, datë 19.10.1997 në favor të Kimete Bedinit për kompensimin fizik të tokës së saj bujqësore në fshatin Armen, me 4131.8 m² në parcelën nr.31 Jonufër-Vlorë, si dhe pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit me nr.676 Rep. e 456 Kol., datë 10.09.1999 me anë të së cilës Kimete Bedini i ka dhuruar djalit të saj, Artan Liçaj, 4231.8 m² me vendndodhje në Parcelën nr.31 Jonufër-Vlorë.

Anulimin e vendimit nr.38, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë, pikën 3 të tij, dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliu, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit. Anulimin e pikës 1 të vendimit nr.38/1, datë 18.5.1994 të KKK Pronave Vlorë dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliu, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Anulimin e vendimit nr.81, datë 14.6.1995 dhënë në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut, pronë që ka mbivendosje dhe ndodhet brenda pronës së pretenduar nga paditësit. Anulimin e vendimit nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, si dhe të vendimit nr.18, datë 15.1.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, me të cilin është ndryshuar pika 2/a e vendimit nr.52, vendim me anë të të cilit janë njohur pronarë e u është kthyer prona trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut, pronë (për pjesën), e cila ka mbivendosje dhe është brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Detyrimin e të paditurve Fatie Maskaj e Shyqyrete Gega, trashëgimtarëve ligjorë të Ibrahim Aliut (Gega), të njohin paditësit pronarë në lidhje me sipërfaqet e tokës së trajtuar me vendimet nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 14.6.1995 të KKK Pronave Vlorë dhe nr.52, datë 13.7.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, që janë brenda pronës së pretenduar nga paditësit.

Detyrimin e ZVRPP Vlorë të fshijë nga regjistrimi në ZRPP Vlorë të pronave të trajtuara nga vendimet e KKK Pronave nr.38, datë 18.5.1994, nr.38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 4512

14.6.1995, nr.63, datë 19.10.1997 e nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë. Detyrimin e ZVRPP Vlorë të regjistrojë në favor të trashëgimtarëve të Esheref e Mynevere Boçari të pronave objekt i vendimeve nr.58 dhe nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë. Të vendoset masë e përkohshme e sigurimit të padisë, duke mos lejuar tjetërsimin e pronave në ZRPP, prona të paluajtshme të trajtuara nga KKK Pronave Vlorë e që janë objekt i anulimit në këtë kërkesëpadi, si dhe depozitim të kërkesëpadi në ZVRPP Vlorë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në bazë të nenit 62 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar ankim të veçantë Agron Boçari dhe Gjon Boçari, të cilët kërkojnë prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes në Gjykatë të Shkallës së Parë Vlorë për të vazhduar gjykimin, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Ky vendim është në kundërshtim me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, neni 18, si dhe interpretim të gabuar të vendimit unifikues nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara në Gjykatën të Lartë.

- Nga ana jonë janë ezauruar ankimet administrative deri në Agjencinë e KK Pronave Tiranë në lidhje me vendimet që nuk na kanë njohur pronësinë dhe që i kishin njohur pronësinë palës së paditur.

- Agjencia është shprehur se provat për vendimin e dhënë në favor të Ibrahim Aliut ishin të plota dhe në këtë mënyrë ne nuk na ngele gjë për ankim administrativ, por ngelej vetëm rruga gjyqësore.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.11.2009, ka vendosur:

Kalimin e çështjes nr.01486-00-2009 i Regj. Themeltar për gjykim në Kolegjet e Bashkuara për të unifikuar praktikën gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Andi Çeliku dhe Mirela Fana; pasi dëgjuan përfaqësuesin e palës paditëse, Avokatin Ervin Pupe, i cili kërkojë prishjen e vendimit nr.1814, datë 6.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e kësaj çështjeje në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimin; dëgjuan përfaqësuesin e palës së paditur AKK Pronave, juristin Andi Çuadri, i cili kërkojë lënien në fuqi të vendimit nr.1814, datë 6.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dëgjuan avokatin e shtetit Kadri Skera, i cili kërkojë lënien në fuqi të vendimit nr.1814, datë 6.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dëgjuan përfaqësuesin e palës së paditur Artan Liçaj, Avokatin Gëzim Liçaj, i cili kërkojë prishjen e vendimit nr.1814, datë 6.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e kësaj çështjeje në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimin; dhe si shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Se vendimi nr.1814, datë 6.7.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile nr.2114 regj.them., datë 30.5.2008, me palë ndërgjyqëse paditëse Agron Boçari, palë të paditura Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Fatie Maskaj, Shyqyrete Gega, Kimete Bedini, Artan Liçaj, person i tretë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me objekt të sipërpërmendur, është i pambështetur në ligj dhe për rrjedhim ky vendim duhet të priset dhe çështja duhet të dërgohet në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimin.

Rrethanat e çështjes

Nga materialet e çështjes ka rezultuar se në bazë të dëshmisë së trashëgimisë nr.11930, datë 4.10.1993 të Zyrës së Noterisë Vlorë, paditësi Agron Boçari është trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësve Esheref dhe Mynevere Boçari.

Mbi kërkesën e paditësit, pala e paditur, Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, me vendimin nr.58, datë 31.8.2007 ka vendosur mosnjohjen e të

drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të Esheref dhe Mynevere Boçari, mbi një sipërfaqe prej 950 vreten të ndodhur në rrethin e Vlorës.

Pala paditëse, duke mos qenë dakord me këtë vendim, e ka kundërshtuar pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, e cila me vendimin nr.415, datë 22.4.2008 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.58, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë.

Po mbi kërkesën e palës paditëse, Zyra Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë, me vendimin nr.59, datë 31.8.2007, ka vendosur mosnjohjen e të drejtës së pronësisë së palës paditëse mbi një sipërfaqe 150 vreten të ndodhur në rrethin e Vlorës.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, mbi kundërshtimin e bërë nga pala paditëse, me vendimin nr.414, datë 22.4.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.59, datë 31.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë.

Nga parashtrimet e palës paditëse, si dhe nga vendimet e sipërpërmendura, rezulton se palët e paditura, Zyra Rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vendimet e tyre për të mos njohur të drejtën e pronësisë të palës paditëse kanë argumentuar se këto prona të pretenduara nga pala paditëse ia ka njohur dhe kthyer me vendime subjekteve të tjerë ish-pronarë.

Konkretisht, me vendimet nr.38, datë 18.5.1994 (pika 3) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Vlorë, me vendimin nr.38/1, datë 18.5.1994 (pika 1) të po këtij Komisioni, me vendimin nr.81, datë 14.6.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Vlorë, me vendimin nr.52, datë 13.8.2007 të Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë dhe vendimit nr.18, datë 15.1.2008 të Drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, u janë njohur dhe kthyer trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut prona që, sipas pretendimeve të paditësit, kanë mbivendosje dhe shtrihen brenda sipërfaqes pronë e tyre.

Në bazë të vendimit nr.63, datë 19.10.1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Vlorë, në favor të palës së paditur Kimete Bedini i është dhënë për kompensim fizik të tokës së saj bujqësore në fshatin Armen një sipërfaqe prej 4131.8 m² në parcelën 31, Jonufër-Vlorë. Këtë sipërfaqe pala e paditur ia ka dhuruar të paditurit tjetër (djalin të saj) Artan Liçaj, në bazë të kontratës së dhurimit me nr.676 Rep. e 456 Kol., datë 10.9.1999.

Paditësi, duke mos qenë dakord me vendimet e dhëna si nga KKK Pronave Vlorë dhe nga Agjencia KK Pronave Tiranë në drejtim të tij, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me padi duke kërkuar anulimin jo vetëm të vendimeve të dhëna në emër të tij, por dhe vendimet e KKK Pronave që ju ka njohur dhe kthyer pronat trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut.

Po në këtë padi paditësi ka kërkuar edhe anulimin e vendimit nr.63, datë 19.10.1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve Vlorë, dhënë në favor të palës së paditur Kimete Bedini, si dhe ka kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit me nr.676 Rep. e 456 Kol., datë 10.9.1999 midis palëve të paditura.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjatë gjykimit, ka marrë në shqyrtim kryesisht çështjen e juridiksionit dhe me vendimin nr.1814, datë 6.7.2009 ka vendosur se kjo çështje nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, por në atë administrativ.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë arsyeton vendimin e saj se: “Pala paditëse duhet të ndiqte dhe të ezauronte më parë rrugën administrative të ankimit kundër vendimeve të kundërshtuara me padi prej tij. Pala paditëse si subjekt kërkuar ka ezauruar rrugën administrative të ankimit ndaj vendimeve nr.58 dhe nr.59, datë 31.8.2007 të ZRAKKP Qarkut Vlorë. Por pavarësisht nga kjo, paditësi, me cilësinë e subjektit të ri pretendues, nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimit për vendimet e dhëna në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut dhe Kimete Bedini. Procedura administrative nuk quhet e ezauruar tërësisht, pavarësisht se nga pala paditëse është ndjekur procedura e ankimit administrativ si subjekt kërkuar, por duhet të ndjekë procedurën e ankimit dhe, vendime të cilat pretendohet se prekin interesat e tij dhe të trashëgimtarëve të tjerë të ish-pronarëve Esheref dhe Mynevere Dano në pronën e pretenduar dhe pse nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të këtyre vendimeve. Vetëm pasi të ketë ezauruar këtë rrugë pala ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Gjykata arrin në këtë konkluzion

mbështetur në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe në vendimin unifikues nr.2 të datës 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara, në të cilën është arritur përfundimi unifikues se: “Ankimi administrativ, parashikuar në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, duhet kuptuar njëjloj, si për ankimet nga subjekti kërkues që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjera kërkuese, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër, por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të aktit. Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuara janë të detyruara të ndjekin procedurën e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t’i drejtohen gjykatës...”.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në bazë të nenit 62 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar ankim të veçantë Agron Boçari dhe Gjon Boçari, të cilët kërkojnë prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes në Gjykatë të Shkallës së Parë Vlorë për të vazhduar gjykimin, si një vendim në kundërshtim me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, neni 18, si dhe interpretim të gabuar të vendimit unifikues nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se nga ana e paditësit janë ezauruar ankimet administrative deri në Agjencinë e KK Pronave Tiranë në lidhje me vendimet që nuk na kanë njohur pronësinë dhe që i kishin njohur pronësinë palës së paditur. Kjo Agjenci është shprehur në vendimet e saj se: “provat për vendimin e dhënë në favor të Ibrahim Aliut ishin të plota...” dhe për rrjedhim paditësi me të drejtë i është drejtuar me padi gjykatës.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi shqyrtoi çështjen në seancën gjyqësore të datës 26.11.2009, ka konstatuar se zgjidhja e kësaj çështjeje ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës së ish-pronarëve”, parë në aspekt të respektimit të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ-së.

Ky Kolegj ka konstatuar se në gjykatat më të ulëta po mbahen qëndrime të ndryshme jo vetëm në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, por edhe qëndrime të ndryshme, për sa i përket juridiksionit gjyqësor apo atij administrativ në shqyrtimin e ankimeve kundër një vendimi të KKKP të dhënë për një subjekt tjetër të shpronësuar, qëndrime të ardhura edhe për shkak të disa përfundimeve unifikuese të vendimit nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për rrjedhojë, ky Kolegj Civil, bazuar në nenin 480 e nenin 481 të KP Civile, me vendimin e datës 26.11.2009, ka vendosur të kalojë për unifikim të praktikës gjyqësore këtë çështje për t’i dhënë përgjigje pyetjes:

-A cenon sigurimi juridik e detyrimi i një subjekti (qoftë edhe jo i shpronësuar) që, për mbrojtjen e një të drejte subjektive apo interesi të ligjshëm të tij, të jetë i detyruar t’i drejtohet, në çdo rast e rrethanë, me ankim administrativ, Agjencisë për njohjen dhe Kthimin e Pronave për të kundërshtuar a goditur një vendim të ish-KKKP-ve apo strukturave ekzistuese, me të cilën ishte njohur dhe/ose kthyer e drejta e pronës subjektit të shpronësuar?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje është e domosdoshme që të bëhet një interpretim sistematik i dispozitave të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve”, duke mbajtur parasysh që të garantohet respektimi i parimeve kushtetuese të ligjshmërisë, sigurisë juridike etj., për sa u përket çështjeve që lidhen me të drejtën e pronësisë si një e drejtë subjektive dhe me mbrojtjen e saj edhe në çështjet që lidhen me procesin e njohjes dhe kthimit të pronave të ish-pronarëve.

Nisur nga neni 4 i Kushtetutës së Shqipërisë, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë shtetërore. Nëse për kërkimin, njohjen apo mbrojtjen e një të drejte themelore, sikurse është edhe e drejta e pronësisë, përfshirë edhe procesi specifik i njohjes dhe kthimit të pronës ish-pronarit, nuk do të ekzistojnë kufij kohorë dhe juridiksionalë në të drejtën për t’iu drejtuar dhe në të drejtën për të vendosur nga ana e disa organeve shtetërore, atëherë do të cenohej haptazi parimi i sigurisë juridike, e drejta dhe besimi i individëve se mund të gëzojnë të pashqetësuar pronën e tyre, pasi kjo e drejtë u është njohur më parë në mënyrë përfundimtare, sipas rastit, me një akt të organit shtetëror a një vendimi gjyqësor.

Respektimi i së drejtës së pronës dhe i sigurisë juridike janë çështje që lidhen drejtpërdrejt me respektimin e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë çështje, posaçërisht për sa i përket procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës ish-pronarëve, nga ana e Gjykatës së Strasburgut janë dhënë disa vendime, si: Driza kundër Shqipërisë, Ramadhi kundër Shqipërisë etj.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, për zgjidhjen e çështjes së juridiksionit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes (edhe në rastin konkret objekt gjykimi), e cila ka të bëjë me kundërshtitë mes palëve ndërgjyqëse mbi të drejtën themelore të pronës, gjykatat duhet të mbajnë parasysh interpretimin e drejtë të dispozitave procedurale civile e administrative, si dhe atyre të legjislacionit të posaçëm për njohjen dhe kthimin e pronave ish-pronarëve, në përputhje me parimet themeltare kushtetuese të sigurisë juridike, shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve.

Në këtë kontekst, Kolegjet e Bashkuara mbajnë parasysh se Gjykata Kushtetuese është shprehur në disa vendime të saj lidhur me rëndësinë vendimtare të respektimit të këtyre parimeve nga ligjvënësi, administrata shtetërore dhe gjykatat në procesin kompleks të njohjes dhe kthimit të pronës ish-pronarëve.

Kështu, në lidhje me juridiksionin e detyrueshëm për shqyrtimin e mosmarrëveshjes për kundërshtimin e vendimeve të ish-KKKP-ve apo të strukturave aktuale të kthimit e kompensimit të pronës, që nuk i kanë njohur a kthyer pronën ish-pronarit për arsye se, me një vendim të mëparshëm ia ka njohur një subjekti tjetër të shpronësuar, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.27, datë 27.7.2009, pasi arsyeton lidhur me standardin kushtetues “të gjykatës së krijuar me ligj”, detyrimet që rrjedhin nga parimi i shtetit të së drejtës dhe ai i ndarjes e balancimit të pushteteve, qartazi është shprehur se:

“Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari u drejton organeve përkatëse të administratës publike. Sipas nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, nëse individi kërkues nuk është dakord me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimet e organeve të administratës ka të drejtë t’i kundërshtojë në gjykatë, përveç kërkuesve, edhe çdo person tjetër që pretendon për vete të drejta pronësie.....

Gjatë gjykimit të iniciuar prej subjekteve të mësipërme, përveç të tjerave, hetohet dhe vërtetohet dhe fakti nëse këtyre subjekteve u është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe, çdo vendim gjykate që do të anulonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës të administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tyre të pronësisë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese çmon se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e iniciuar nga të tilla subjekte, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm që të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Megjithatë, shqyrtimi i një mosmarrëveshjeje të tillë duhet të kufizohet vetëm në pronën që është objekt i vendimeve të organit administrativ, dhe jo të shtrihet në prona të tjera që nuk janë objekt i këtyre vendimeve, pasi, siç u parashtua më sipër, njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës i takon fillimisht juridiksionit administrativ, ndërsa gjykata, me ankesë të individit, shprehet mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të organeve të administratës, pasi ato të kenë marrë vendimin përkatës....”.

Po kështu, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.27, datë 26.5.2010, duke shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën dispozitat e ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar) për ankimimin administrativ (të detyrueshëm ose jo) ndaj vendimeve të ish-KKKP-ve të nxjerra para hyrjes në fuqi të tij, si dhe për kompetencën e Drejtorit të AKKKP për të cenuar edhe kryesisht vendimet e ish-KKKP-ve apo zyrave rajonale të AKKP-së, është shprehur se:

“..... zbatimi, nga një organ administrativ si AKKP-së, i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP është i pabazuar, pasi mungon një interes i ligjshëm shtetëror dhe aktet që shfuqizohen ose revokohen nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ. Drejtori i AKKP-së është një organ në vartësi të Këshillit të Ministrave dhe në këtë kuptim vendimi i marrë prej tij për të ndërhyrë mbi interesa civile të shtetasve, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është i pajustificuar....

.... Gjykata çmon se vendimet e AKKP-ve për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve, përbëjnë cenim të parimit të sigurisë juridike....

.... vendimi i KKKP-së, i cili nuk është ankimuar brenda afateve ligjore, merr formën e prerë. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë, duke cilësuar vendimet e paankimuara të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si “të formës së prerë dhe të ekzekutueshme”.....”.

Nisur nga parashtrimet e mësipërme lidhur me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Kushtetutës e të KEDNJ-së, si dhe të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve” (i ndryshuar), duke pasur parasysh edhe qëndrimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së mbi procesin e kthimit dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se është vendi për të ndryshuar edhe qëndrimet e tyre të mëparshme të shprehura me vendimin unifikues nr.2, datë 6.1.2009.

Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se subjektet e shpronësuara kanë detyrimin që t’i drejtohen organit administrativ, pra AKKP-së, vetëm në dy situata.

Së pari, në rastin kur subjektet e shpronësuara paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës në cilësinë e ish-pronarit.

Së dyti, në rastin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në emër të tyre e mbi kërkesën e tyre nga (ish) zyra rajonale e AKKKP-së, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar).

Gjithsesi, edhe në këto dy raste, çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, pra detyrimi për t’iu drejtuar rrugës përkatëse administrative të kërkesës dhe ankimit nuk ekziston, nëse nga subjekti i shpronësuar pretendohet që, për të njëjtën pronë, ish-KKKP-të apo AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimin e pronës një subjekti tjetër të shpronësuar.

Nisur nga sa parashtrohet më sipër, për sa i përket zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, duke qenë se nga paditësi Agron Boçari kundërshtohen vendimi nr.58, datë 31.8.2007, vendimi nr.415, datë 22.4.2008, vendimi nr.59, datë 31.8.2007 dhe nr.414, datë 22.4.2008 i ish-KKKP Vlorë në pjesën që nuk i ka njohur e kthyer një pjesë të pronës, sepse për të njëjtën sipërfaqe është disponuar në favor të të paditurve trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit Ibrahim Aliu me vendimin nr.38, datë 18.5.1994, vendimin nr.38/1, datë 18.5.1994, vendimin nr.81, datë 14.6.1995 dhe vendimin nr.63 datë 19.10.1997 të dhënë në favor të të paditurës Kimete Bedini, Kolegji Civil vlerëson se çështja objekt gjykimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor. Ky qëndrim gjen mbështetje edhe në përfundimet unifikuese të vendimit nr.4, datë 25.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi paditësi nuk bën pjesë në “subjektet e shpronësuara” që janë trajtuar me këto vendime të ish-KKKP-ve dhe AKKP-ve.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se juridiksioni gjyqësor ushtrohet edhe lidhur me kërkimet për kundërshtimin e vendimit nr.38, datë 18.5.1994, vendimit nr.38/1, datë 18.5.1994, vendimit nr.81, datë 14.6.1995 dhe vendimin nr.63, datë 19.10.1997 i ish-KKKP Vlorë për të paditurit trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarit Ibrahim Aliut dhe të paditurës tjetër Kimete Bedinaj, edhe për një arsye tjetër. Këto vendime janë nxjerrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar).

Së fundi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se juridiksioni gjyqësor ushtrohet edhe për kundërshtimin në padi të vendimit nr.52, datë 13.8.2007 të zyrës rajonale të AKKP Vlorë dhe vendimit nr.18, datë 15.1.2008 të Drejtorit të AKKP Tiranë, të dhëna në favor të të paditurve trashëgimtarë të Ibrahim Aliu, si për arsyen se me këto vendime këtyre të paditurve u janë njohur e kthyer të njëjtat prona për të cilat ka pretendime si ish-pronare pala paditëse, ashtu edhe për arsyen se, për një interes të ligjshëm të pretenduar nga paditësi, kjo palë gjyqësisht po kundërshton vendime të AKKP-ve të dhëna për një subjekt tjetër të shpronësuar. Ky qëndrim gjen mbështetje edhe në përfundimet unifikuese të vendimit nr.4, datë 25.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi paditësi nuk bën pjesë në “subjektet e shpronësuara” që janë trajtuar me këto vendime të ish-KKKP-ve dhe AKKP-ve.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.1814, datë 6.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, jemi të mendimit se vendimi nr.1814, datë 6.7.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja civile me palë paditëse: Agron Boçari; të paditur ZRAKKP Vlorë, Fatije Maskaj etj.; me objekt “Anulimin si të pabazuar të vendimeve të KKK Pronave nr.58, datë 31.8.2007 ...”, është i mbështetur në ligj dhe si i tillë duhej të lihej në fuqi.

Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se mbi kërkesën e paditësit Agron Boçari (trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësve Eshref dhe Mynevere Boçari), ZRKKP Vlorë me vendimet nr.58, dhe nr.59, datë 31.8.2007 ka vendosur mosnjohjen e të drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të Eshref dhe Mynevere Boçari për dy prona të përbëra respektivisht nga 950 vreten dhe 150 vreten, të ndodhura në rrethin e Vlorës. Mbi ankimin e tij ndaj dy vendimeve të mësipërme, AKKP Tiranë me vendimet nr.414, dhe 415, datë 22.4.2008 ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve nr.58 dhe 59, datë 31.8.2007 të ZRKKP Vlorë.

Nga përmbajtja e vendimeve respektive rezulton se shkak i mos njohjes së pronave të pretenduara prej paditësit Agron Boçari në ZRKKP Vlorë dhe rrëzimit të ankimeve të tij nga AKKP Tiranë është se këto prona u janë kthyer subjekteve të tjera, e konkretisht: trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut, me vendimet nr.38, 38/1, datë 18.5.1994, nr.81, datë 14.6.1995 të KKKP Vlorë, nr.18, datë 15.1.2008 të drejtorit të AKKP dhe Kimete Bedinit me vendimin nr.63, datë 19.10.1997 të KKKP Vlorë (kompensim fizik të tokës bujqësore).

Me pretendimin se pronat e njohura dhe të kthyer nëpërmjet vendimeve të mësipërme të KKK Pronave në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut dhe Kimete Bedinit mbivendosen me pronën e pretenduar prej tij, paditësi Agron Boçari i ka kundërshtuar gjyqësish vendimet e KKK Pronave të dhëna në favor të tij, po kështu dhe vendimet përkatëse të dhëna në favor të të paditurve.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1814, datë 6.7.2009, ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështjen objekt gjykimi, pasi ka arritur në përfundimin se paditësi nuk ka ezauruar tërësisht rrugën administrative të ankimit për vendimet e KKK Pronave (objekt kundërshtimi gjyqësor), duke parashtruar se: si subjekt kërkues pala paditëse ka ezauruar rrugën administrative të ankimit ndaj vendimeve nr.58, dhe 59, datë 31.8.2007 të zyrës rajonale të KK Pronave Qarku Vlorë në Agjencinë Qendrore të KK Pronave Tiranë, por, me cilësinë e subjektit të ri pretendues, nuk ka ezauruar rrugën administrative të ankimit për vendimet e dhëna në favor të trashëgimtarëve të Ibrahim Aliut dhe Kimete Bedinit. Gjykata ka arritur në këtë konkluzion në interpretim të nenit 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe vendimit nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke konstatuar se në gjykatat më të ulëta janë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket juridiksionit gjyqësor apo atij administrativ në shqyrtimin e ankimeve kundër një vendimi të KKKP-së të dhënë për një subjekt tjetër të shpronësuar (qëndrime të ardhura edhe për shkak të disa përfundimeve unifikuese të vendimit nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë), ka vendosur të kalojë çështjen për unifikim të praktikës gjyqësore.

Shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka konkluduar se duhen ndryshuar qëndrimet e mëparshme të shprehura me vendimin unifikues nr.2, datë 6.1.2009, duke arritur në përfundimin se:

subjektet e shpronësuar kanë detyrimin që t'i drejtohen organit administrativ, pra AKKP-së, vetëm në dy situata:

1. Në rastin kur subjektet e shpronësuar paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës në cilësinë e ish-pronarit.

2. Në rastin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në emër të tyre e mbi kërkesën e tyre nga (ish) zyra rajonale e AKKP-së, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar).

Edhe në këto dy raste, çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, pra detyrimi për t'iu drejtuar rrugës përkatëse administrative të kërkesës dhe ankimit nuk ekziston, nëse nga subjekti i shpronësuar pretendohet që, për të njëjtën pronë, ish-KKKP-të apo AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimin e pronës një subjekti tjetër të shpronësuar.

Në arritjen e këtij përfundimi shumica është referuar në vendimin nr.27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese, e cila pasi ka arsyetuar lidhur me standardin kushtetues “të gjykatës së krijuar me ligj”, është shprehur se “Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari i drejton organeve përkatëse të administratës publike. Sipas nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, nëse individ i kërkuar nuk është dakord me vendimin e komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimet e organeve të administratës ka të drejtë t'i kundërshtojë në gjykatë, përveç kërkuarëve, edhe çdo person tjetër që pretendon për vete të drejta pronësie...” dhe në vendimin nr.27, datë 26.5.2010 të po kësaj gjykate, e cila është shprehur se: “... zbatimi, nga një organ administrativ si AKKP i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP është i pabazuar, pasi mungon një interes i ligjshëm shtetëror dhe aktet që shfuqizohen ose revokohen nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ. Drejtori i AKKP-së është një organ në vartësi të Këshillit të Ministrave dhe në këtë kuptim vendimi i marrë prej tij për të ndërhyrë mbi interesa civile të shtetasve, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është i pajustificuar....

...Gjykata çmon se vendimet e AKKP për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve, përbëjnë cenim të parimit të sigurisë juridike.... vendimi i KKKP-së, i cili nuk është ankimit brenda afateve ligjore merr formën e prerë. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen “Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë” duke cilësuar vendimet e paankimuara të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si “të formës së prerë dhe të ekzekutueshme”.....”.

Në këtë kontekst, për çështjen objekt gjykimi shumica ka vlerësuar se ajo bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, duke e konsideruar të ezauruar rrugën administrative për vendimet objekt padie të dhëna në emrin e tij, ndërsa për vendimet e KKK Pronave të dhëna në favor të të paditurve paditësi nuk bën pjesë në “subjektet e shpronësuar”, që janë trajtuar me këto vendime të ish-KKKP-ve dhe AKKP-ve.

Nisur nga objekti i kërkesëpadsë, vendimet e KKK Pronave objekt kundërshtimi dhe ecurinë e procedurës administrative të ndjekur nga pala paditëse në kuadrin e kundërshtimit të tyre, pakica është e mendimit se paditësi nuk e ka ezauruar plotësisht rrugën administrative të ankimit dhe me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor këtë çështje.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe më parë, duke marrë shkas nga një çështje tjetër analoge e Gjykatës së Rrethit Korçë (e cila e kishte nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor), kanë marrë në shqyrtim dhe kanë unifikuar praktikën gjyqësore me vendimin nr.2, datë 6.1.2009, nëpërmjet të cilit, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga çështja në shqyrtim, kanë lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke konkluduar se: Ankimi administrativ, parashikuar në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, duhet kuptuar dhe zbatuar njëjloj si për ankimet nga subjekti kërkuar që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjera kërkuarë, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër, por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të aktit.

Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuara janë të detyruara të ndjekin procedurat e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t'i drejtohen gjykatës.

I qëndrojmë kësaj sentence unifikuese të vendimit nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në këtë kontekst, mënyrën e zgjidhjes së çështjes në shqyrtim nga ana e shumicës e konsiderojmë në interpretim të gabuar të nenit 18 dhe të frymës në përgjithësi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Kjo për arsye se, nga shpallja e vendimit nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara deri në momentin e shqyrtimit të çështjes në fjalë, ligji nr.9235, datë 29.7.2004 nuk ka pësuar ndryshime në pjesën që parashikon procedurën e ankimit ndaj vendimeve; po kështu nuk rezulton që kjo pjesë e ligjit të jetë cenuar (shfuqizuar) nga ana e Gjykatës Kushtetuese, as me vendimet në të cilat është referuar shumica, as me vendime të tjera të asaj gjykate.

Vendimi nr.27, datë 27.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese (në të cilin është referuar shumica në përfundimet e saj) është referuar në vendimin nr.2, datë 6.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke cituar se “Legjitimiteti i këtyre subjekteve, si pjesë e praktikës së zakonshme gjyqësore, është pranuar dhe nga Gjykata e Lartë, që sipas nenit 141/2 të Kushtetutës ka bërë njësimin e praktikës gjyqësore”.

Neni 2 i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 parashikon të drejtën e çdo “subjekti të shpronësuar”, që në përputhje me këtë ligj, të kërkojë të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944. Në dispozitat e nëneve në vijim, në të cilat sintetizohet dhe qëllimi i ligjit (njohja e së drejtës së pronësisë dhe kthimi e pronës), ligjvënësi në të gjitha rastet përdor termin “subjekte të shpronësuara”.

Me të gjitha ndryshimet e pësuar, ligjvënësi, në një sërë dispozitash të ligjit, ka parashikuar hollësisht zhvillimin e një procedure të hollësishme dhe të plotë për organet administrative të ngarkuara me ligj, të cilat mbi kërkesën e “subjektit të shpronësuar” nxjerrin akte për njohjen dhe kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, duke u dhënë të drejtë të kontrollojnë vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga “subjektet e shpronësuara”, të verifikojnë dhe llogarisin detyrimet financiare që lindin për shtetin; të caktojnë ekspertë, të cilët ndihmojnë komisionin në anën teknike në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës etj. Organin epror që mbikëqyr procedurën administrative të nxjerrjes së akteve dhe njëkohësisht kryen funksionin e shqyrtimit të ankimeve administrative të ushtruara nga “subjektet e shpronësuara” në kuptim të këtij ligji kundër akteve të dhëna nga organet më të ulëta, afatet e ushtrimit të ankimit administrativ dhe së fundi, të drejtën e ankimit në gjykatë të subjekteve të shpronësuar (nenet 18, 19, 20).

Siç shihet, ligjvënësi u ka dhënë kompetencë të plotë organeve administrative të specializuara për shqyrtimin e ankimeve administrative, si organe të cilat u kanë të gjitha mundësitë ligjore dhe institucionale për kryerjen e një hetimi dhe verifikimi të plotë administrativ gjatë procedurës për nxjerrjen e akteve administrative për pronësinë.

Nga përmbajtja e dispozitave të ligjit në tërësi dhe nga ajo e nenit 18 në veçanti del se, në ushtrimin e ankimit administrativ ndaj një vendimi të ZRKKP-së, ligjvënësi përdor vetëm termin “subjekt i shpronësuar” duke mos bërë asnjë diferencim mes “subjektit të shpronësuar”, i cili ushtron ankim administrativ ndaj një vendimi të dhënë në favor të tij apo ndaj një vendimi të dhënë ndaj një subjekti tjetër të shpronësuar, por që është bërë shkak për mosnjohjen e pronës.

Në këtë mënyrë, kërkesa drejtuar zyrës rajonale dhe eventualisht ankimi nga subjekti pretendues kundër aktit administrativ të kontestuar, të dhënë në favor të një subjekti tjetër, janë “mjete efektive” të ankimit administrativ, sepse së pari: e detyrojnë organin përkatës të rishikojë me prova dhe pretendime të reja aktin e mëparshëm administrativ të nxjerrë prej tij; dhe së dyti organi administrativ që shqyrton ankimin, si ai që ka nxjerrë aktin, ashtu dhe organi epror i tij, sipas nenit 18 të ligjit të cituar më lart dhe nenit 146 të KP Administrative, ka në kompetencë të vendosë lënien në fuqi, shfuqizimin, ose ndryshimin e aktit administrativ të ankimuar.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.27, datë 26.5.2010 arsyeton: “Kërkesa e një personi para organeve të kthimit e kompensimit të pronave synon njohjen e së drejtës së pronës mbi një send të caktuar. Kjo e drejtë e pretenduar nga subjekti para një organi shtetëror është një e drejtë

subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të KP Civile.... vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik (*strictu sensu*), por akte suis generis të nxjerra nga një organ *suis generis*, për të cilin Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, *quasi gjykatë ...*”.

Procedura e nxjerrjes së këtyre akteve, parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004, i ndryshuar, harmonizohet edhe me nenin 137/3 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “Në parim, palët e interesuara mund t’i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ”. Dhe në rastin konkret “palë e interesuar”, sipas nenit 137/3 të KP Administrative, duhet të kuptohet “subjekti i shpronësuar” në kuptim të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, i cili, pasi ka ezauruar në mënyrë të plotë procedurën e ankimit administrativ ndaj një vendimi të dhënë në zbatim të atij ligji, ka të drejtën që t’i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e konfliktit gjyqësor (neni 18 i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, i ndryshuar).

Kjo nuk duhet ngatërruar me kategorinë e “personave të interesuar”, të cilët cenohen nga një vendim i KKKP, por që mbajnë pronën me një titull tjetër ligjor.

Këtij problemi i ka dhënë zgjidhje vendimi nr.4, datë 24.3.2005 i Kolegjeve të Bashkuara, i cili ka arritur në përfundimin se: pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjitha rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave është ngritur nga persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Legjitimitimi i kësaj kategorie për të ngritur padi në gjykatë lidhet me të drejtën që jep neni 32 i KP Civile për ngritjen e padisë (interesi i ligjshëm).

Konfuzion lidhur me mënyrën e goditjes së vendimeve të KKKP-së edhe nga ana e “subjekteve të shpronësuar” është krijuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, pasi në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, neni 27/a i tij, vendimet e komisionit kundërshtoheshin vetëm para gjykatës. Këtij problemi i dha zgjidhje vendimi nr.7, datë 24.3.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka arritur në përfundimin unifikues se “të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të komisioneve të kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve, që janë marrë në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ”. Ndërsa, për paditë që ngriheshin nga këta subjekte pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 edhe kur bëhet fjalë për kundërshtimin e një vendimi të KKKP të dhënë në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, është e qartë se “subjekti i shpronësuar” duhet të ndjekë ankimin administrativ, mandej mund ta kundërshtojë atë në gjykatë.

Për sa më sipër, lidhur me çështjen në shqyrtim, paditësi, me cilësinë e personit që kundërshton një vendim të KKKP-së qoftë edhe në favor të një subjekti tjetër të shpronësuar, por që cenon të drejtën e tij të pronësisë në kuptim të këtij ligji, përpara se t’i drejtohet rrugës gjyqësore të ankimit duhet të ezaurojë procedurën e plotë të ankimit administrativ të vendimeve, objekt kundërshtimi në padi, përpara organit administrativ të krijuar me ligj, sipas nenit 18 të ligjit dhe nenit 137 të KP Administrative dhe në rast se nuk e zgjidh këtë të drejtë nëpërmjet këtij ankimi administrativ, i lind e drejta ligjore për t’iu drejtuar rrugës gjyqësore.

Për të gjitha arsyet e parashtruara në këtë pakicë, mendojmë se ezaurimi i plotë i ankimit administrativ, në përputhje me ligjin specifik në raste si ky në shqyrtim, nuk përbën “cenim të parimit të sigurisë juridike”, pasi me këtë logjikë juridike “siguria juridike” cenohet njëloj edhe nëpërmjet goditjes së këtyre akteve administrative nëpërmjet ngritjes së padisë në gjykatë.

Anëtarë: Andi Çeliku Shpresa Beçaj

KËRKESË

Shtetësja Gentiana Ahmetli (Shala), e bija e Hylviut dhe e Natashës, e datëlindjes 3.1.1977, lindur dhe banuese në Bilisht të rrethit Devoll, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Ahmetli.

KËRKUESJA
Gentiana Ahmetli

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 15.8.2011
Doli nga shtypi më 17.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë